

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

Tani, se ku është arritja e qeverisë shqiptare kur kjo është një marrëveshje e kërkuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe, ministri mund ta gjejë, sepse ka arritje, por përfaqësuesit e qeverisë, të dy zëvendësit tuaj në Komisionin e Sigurisë, thanë se kjo është një marrëveshje e kërkuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe. Ndërkohë që qeveria shqiptare ka bërë vizitë në Dubai, siç u tha, emiratet kanë kërkuar marrëveshje. Qeveria, kuptohet, shkon për te Nusreti, ndërsa Emiratet e Bashkuara Arabe kërkojnë një marrëveshje për të thelluar bashkëpunimin dhe për të ndarë informacion, sepse kanë shqetësim kriminel shqiptar.

Po cili është shqetësimi i Shqipërisë, për të ndarë informacion apo është shqetësim për të sjellë të gjithë kriminelët, gjë që është kthyer anekdotë në çdo vend të Shqipërisë, se pushka dhe vrasja kërcasin në Shqipëri, porositësit hapin shampanjë në Dubai, se atje janë porositësit e vërtetë të vrasjeve? Keni shumicën e personave që janë dënuar me burgim të përjetshëm apo janë shpallur në kërkim nga SPAK-u që jetojnë të lirë atje, nuk ka nevojë për ndonjë informacion të madh. Ta ka thënë çdo media, e keni edhe ju si qeveri informacionin. Në vend që të kërkoni të gjithë si qeveri lehtësim procedurash për ekstradim, bashkë me Ministrinë e Drejtësisë, ju bëni një gjë që e kërkojnë Emiratet e Bashkuara Arabe, që janë në të drejtën e tyre ta kërkojnë dhe shumë mirë bëjnë.

Në këtë situatë qeveria thotë se ka arritur ta bëjë marrëveshjen, sepse është për informacion. Po më përpara nuk kemi pasur ne këmbim informacioni me Emiratet e Bashkuara Arabe? Nuk kemi ne? Jemi han pa porta dhe nuk dimë asgjë se ku veprojnë shtetasit shqiptarë? A ka njeri në Shqipëri që nuk e di, edhe qytetari më i thjeshtë, se urdhëruesit, porositësit, krerët e grupeve të krimit të organizuar, një pjesë e përdorur në fushatë nga deputetë apo familjarë të Partisë Socialiste, e ushtrojnë aktivitetin e tyre kriminal nga Dubai, me telefon? Pse nuk e kërkon qeveria? Ka ndonjë shqetësim, se mos vijnë këtu ata dhe nxjerrin emrat e politikanëve që i kanë ndihmuar apo kërkon t'u japë një parajsë të sigurt, ku jo vetëm të mos i prekë asgjë,

por edhe të shkojnë në vendet më të rëndësishme turistike në botë për të jetuar për shtatë palë qejfe, duke llapur kudo nëpër media se një bandë rri në një lokal, banda tjetër rri përballë, por atje nuk preken dot, se funksionon ligji, dhe vijnë i vrasin këtu, në mënyrë të organizuar, duke u porositur që atje?

Cili është qëllimi i qeverisë shqiptare apo çfarë arritjeje ka qeveria shqiptare nga kjo marrëveshje? Vetëm këmbim informacioni, i njëjti muhabet! E njëjta gjë edhe me memorandumin që kemi pastaj me Mbretërinë e Bashkuar. Madje, të gjitha vijnë jo për shkak të arritjeve të qeverisë shqiptare, por për shkak të dështimit të madh të qeverisë shqiptare në raport me gjendjen e krimit. E patë sot besoj, se mos ju vijë një tjetër nga Meksika dhe thoni është arritje jona, se e kishin mediat meksikane sot: “Karteli Sinaloa, lidhje me mafien shqiptare”. Strukturat e inteligjencës atje ngrenë një nivel tjetër shqetësimi: “El Mayo” Zambada (se këta kanë edhe emra ekzotikë) aleat me mafien në Shqipëri, pastrim parash me miliona euro!”

Dhe ku pastrohen këto para? Te këto ndërtimet që janë me dhjetëra kate këtu! Dhe ku pastrohen këto para, zoti Ministër, se në fushë të përgjegjësisë keni edhe ndërtimet e paligjshme? E mbani mend besoj se si vartësit tuaj të sotëm, kur kanë qenë në krye të Inspektoratit të Ndërtimit, kur ka pasur komuna dhe bashki Partia Demokratike, pa jua bërë siç jua bëri dhuratë në vitin 2019, ku pas çdo ndërtimi të paligjshëm dilnit në çdo cep, apo edhe drejtoresha e sotme ose kryeinspektorja e sotme e IKMT-së thoshte: “Kallëzojmë penalisht kryetarin e bashkisë iks. Kallëzojmë penalisht kryetarin e komunës ypsilon”.

Po sot pse nuk e bëni ju këtë? Pse nuk kallëzoni penalisht jo vetëm kryetarët e bashkive, inspektorët, shefat e komisariateve, ministrat, po edhe Kryeministrin që rri me këta që ndërtojnë pa leje? Ndërkohë që keni dënuar, kanë nxjerrë tri raste shumë sinjifikative. Një e nxori media dje për një zonjë të moshuar 81-vjeçe, e cila arrestohej për ndërtimin e një koteci pulash në Vlorë; një tjetër 60 e kusur vjeç, me një motoçikletë, siç njihet në gjuhën popullore, papaq, e kapët në Peqin dhe e rrasët 21 ditë në burg, se kishte mistri me vete dhe plumbçe; një rast tjetër në Kavajë e futët në burg, se po bënte avllinë e shtëpisë. Dhe e dini dramën që pasoi kur i shkonin familjarët në burg, duke humbur edhe dy fëmijët?

E ndërkohë që këta i fusnin në burg, tek të gjithë të tjerët që nuk përfundojnë në burg, shkojnë më parë inspektorët tuaj për t'u marrë ryshfet, sesa shkon ustai për t'i ndërtuar banesën. Për këta me katet pa leje nuk keni thënë gjysmë fjale dhe jo vetëm kaq, por keni bërë një akt të pashembullt: po legalizoni ndërtimet e paligjshme, duke i bërë ata akoma më shumë milionerë dhe, ndërkohë, po i shmangni në shkelje të ligjit, se nuk e keni ju tagrin nga një vepër penale për të cilën prokuroria shqiptare në katër vjetët e fundit ka referuar thuajse 9000 qytetarë shqiptarë.

Ku e gjen të drejtën qeveria që, në vend që të referojë në prokurori të gjithë këta që ndërtojnë pa leje, i bën akoma më shumë milionerë, duke shmangur ata 8%-shin e taksës që paguajnë në bashki, duke shmangur përqindjen që paguajnë për pronarët dhe duke e marrë me çmimin e referencës, që është, siç e dimë të gjithë, pothuajse tre apo katër herë më pak sesa çmimi real i pronave në ato zona? Ja, kjo është ajo që bën qeveria! Sepse është e kapur. Dhe si në rastin e kësaj marrëveshjeje me Emiratet, keni rastin tjetër. Madje dua t'ju pyes, zoti Ministër, meqenëse jeni këtu, sepse Kryeministri sot, por do ta them në fund, se nuk duket dhe kuptohet arsyeja përse: a u kap?

E kemi denoncuar me muaj se në Shqipëri bëhet kontrabandë. "Jo, nuk bëhet", thotë Rama. Por në Shqipëri bëhet kontrabandë nafte me miliona euro dhe, ndërkohë, çmimet vetëm rriten si në asnjë vend tjetër të rajonit! Çfarë ndodh këtu? Përse nuk ka asnjë emër, siç dilnin në komunikatat e policisë kur arrestohen hallexhinjtë? Cilët janë porositësit e asaj naftës libiane që vjen me anije libiane në Shqipëri? Pesë kanë të drejtë të importojnë në Porto Romano. Është "Kastrati", është "Gega", firma "Alpet"-i, është "Eida" apo është "Bolvoil"-i? Cili nga këta jua ka mbyllur gojën dhe cila është arsyeja përse Policia e Shtetit nuk flet, pavarësisht se kapiteni i anijes libiane ka thënë se ka ardhur edhe dy herë të tjera në këtë vend?

Pra, anija ka hyrë edhe dy herë të tjera kontrabandë, e ka marrë porositësi naftën dhe e ka shpërndarë në treg. Dhe a e dini kur u ndalua? Kur u mor vesh se ajo anije gjurmohej nga partnerët ndërkombëtarë, për shkak se jo vetëm që bën kontrabandë këtu, por ka një rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që ndalon të ketë çfarëdolloj shitblerjeje dhe tregtie me Libinë, përpunim të anijeve që vijnë nga ky shtet. Pse nuk flet qeveria për këtë? A

keni ndonjë përgjigje? Cilët janë porositësit? Cili është porositësi i dy të parave, cili është porositë i dy të dytave dhe i kësaj të fundit që keni kapur?

Si ka mundësi që në Shqipëri vjen një anije me mijëra tonë naftë dhe ndërkohë të arrestuar janë vetëm disa të huaj dhe asnjë shqiptar? Ç'është kjo?! Çfarë janë këta libianë që vijnë direkt nga deti dhe ku e çojnë naftën? Është e njëjta skemë e përdorimit të pushtetit për të bërë ligje vetëm në favor të oligarkëve. Ashtu siç ju kam kërkuar informacion të plotë për të gjithë oligarkët e ndërtimit që nuk janë referuar në prokurori, ne do t'i referojmë në zbatim të Kodit Penal, e njëjta gjë do të ndodhë edhe me këtë rast dhe do t'i informojmë të gjitha vendet partnere, sepse keni thyer embargon për naftën libiane dhe nga ana tjetër, pa diskutim që do ta gjejmë ne, nëse nuk e gjeni këtu, dhe do të vijmë e do t'ju themi këtu, kjo është kompania që po bën kontrabandë, por ju nuk keni fuqi.

Ju do të ngrini duart, i keni ngritur disa herë dhe nuk është se do të keni turp apo do të thoni që nuk kemi zbatuar ligjin. Pra, kjo është situata sot në Shqipëri, turpi është i qeverisë, por kostot i merr Shqipëria për shkak të gjendjes së kriminalitetit, të krimit të organizuar, të kontrabandës, të drogës dhe të pastrimit të parave. Gjatë gjithë verës turpi i Shqipërisë ishte me ato gomonet që niseshin nga Franca për në Angli, besoj se i keni parë, por edhe sot shfaqen, ku një prej mediave nxirrte se si kishin ngrirë qytetarët shqiptarë dhe kërkonin ndihmë në ujërat franceze nëpërmjet medias, që kush kishte mundësi të fliste me institucionet, sepse po mbyteshin dhe po thaheshin atje.

Qeveria gjatë gjithë periudhës së verës nuk ka pasur asnjë reagim, zero, qoftë edhe kjo që ju thatë sot, sepse pa diskutim në këtë pikë ne do t'ju mbështesim, por të dekurajojmë ata që e organizojnë këtë krim të emigracionit të paligjshëm dhe pa diskutim që të mos i marrin kostot të gjithë qytetarët që shkojnë atje. Do t'ju them diçka në mënyrë të përmbledhur, sepse do ta marr përsëri fjalën te pjesa tjetër. Kam një pyetje: sot, Kryeministri, kur Shqipëria është në agresion nga Irani, kur flitet që ka financim nga para ruse, pse nuk vjen të japë shpjegime? Këto gjëra nuk kanë ndodhur më parë në Shqipëri, por ndodhin sot që institucionet janë të shkallmuara.

Pse nuk i jep sot përgjigje Kryeministrit edhe shqetësimit që ambasadorja amerikane e shpërndau zyrtarisht për shqetësimin (mos ndërhyri te kjo që po them se do të dukeni keq pastaj), të cilin e kanë qartësisht të shprehur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e financimit me para ruse që sjellin kërcënim për institucionet dhe demokracinë shqiptare? Për këtë të vinte sot. Një vend sot është në agresion.